



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.27/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Alban Krasniqi, anëtar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3784/2-2025, të datës 18.12.2025, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr. 01/3784-2025 për Miratimin e Rekomandimit për Qendrat e Votimit dhe Numrin e Vendvotimeve në Përfaqësi Diplomatieke, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.A.nr.27/2025, e datës 19.12.2025, e parashtruar nga Alban Krasniqi - anëtar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e parashtruar kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3784/2-2025, të datës 18.12.2025, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr. 01/3784-2025 për Miratimin e Rekomandimit për Qendrat e Votimit dhe Numrin e Vendvotimeve në Përfaqësi Diplomatieke, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 19.12.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e paraqitur nga Alban Krasniqi, anëtar i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ankesa është paraqitur kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3784/2-2025, datë 18.12.2025, ora 15.00, Vendim për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr. 01/3784-2025 për Miratimin e Rekomandimit për Qendrat e Votimit dhe Numrin e Vendvotimeve në Përfaqësi Diplomatieke. Me Vendimin e KQZ mbyllen për votim fizik, përfaqësite diplomatike si në vijim: Ambasada e Republikës së Kosovës — Tokio (Japoni);

Ambasada e Republikës së Kosovës — Tiranë (Shqipëri); Ambasada e Republikës së Kosovës Podgoricë (Mali i Zi); Konsullata e Republikës së Kosovës Iowa (SHBA); Ambasada e Republikës së Kosovës Abu Dhabi (EBA); Ambasada e Republikës së Kosovës-Kanbera (Australi); Ambasada e Republikës së Kosovës-Shkup (Maqedonia e Veriut); Ambasada e Republikës së Kosovës-Ankara (Turqi); Vendimi i KQZ Nr. 01/3784-2025/2-2025, datë 18.12.2025, është në kundërshtim me Nenin 96 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), shprehimisht thekson: Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit numd të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së, fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit. Kjo mënyrë votimi nuk aplikohet në zgjedhje lokale. KQZ, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votimi, si dhe përcakton numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike. Këtu bëhet fjalë për Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës (Rregullorja) e KQZ 04/2025, e cila në Nenin 3, par. 7, nënpar. 7.1, që është vetëm përsëritje e Nenit 96 të LZP, përcakton qartë dhe shprehimisht mënyrën fizike të votimit të votuesve jashtë Kosovës. LZP, në par. 35 nënpar. 3.1, shprehimisht, pa asnjë dilemë, përcakton se votuesi gjatë fazës së regjistrimit për votim jashtë Kosovës përcakton vete mënyrën e votimit fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre. Në këtë rast, KQZ me Vendimin e vet, në mënyrë arbitrare, po ashtu me arsyetim të kundërligjshëm, ka cenuar normen e LZP për përcaktim të votuesve për votim fizik në përfaqësitë diplomatike, si dhe vullnetin e votuesve të shprehur sipas lartcekursës ligjore. Përveq shkeljes së normës ligjore, duke marrë parasysh afatet e shkurtëra dhe largësive të mëdha hapësinore, në të vërtetë është i pamundur dërgimi i fletëvotimeve individuale për votim me postë tek votuesit regjistruar për votim fizik dhe rrjedhimisht pamundësohet votimi i personave që janë regjistruar për votim fizik në përfaqësitë diplomatike të cituara. Kjo është edhe shkelje e rëndë, shkelje kushtetuese dhe ligjore. Arsyetimi i Vendimit të KQZ-së, në disa përfaqësi diplomatike kapacitetet e sfafit nuk janë të mjaftueshme në përmbushjen e kriterëve minimale sipas rregulloreve zgjedhore Për menagjimin e QV-së dhe anëtarë të KVV-ve, po ashtu analiza thekson sfida shtesë operative, logjistike dhe financiare është i kundërligjshëm. Ky arsyetim është në kundërshtim me Nenin 12, par. 8 që shprehimisht thekson se "KQZ është përgjegjëse për plotësimin e vendeve në KVV, në rast se subjektet politike nuk nominojnë anëtarë të KVV. Me tutje thekson se për më shumë, Vendimi i lartëcekur i KQZ shkel edhe normen ligjore të LZP, Neni 96, par. 6, që po ashtu shprehimisht e sqaron dhe përcakton, ndër të tjera, se KQZ përcakton numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike. Pra, ligjvënësi, duke i patur parasysh të gjitha rrethanat, ka përcaktuar vetëm normen numri maksimal të votuesve, por jo edhe numrin minimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike. Përfundimisht, Vendimi i KQZ-së Nr. 01/3784 25/2-2025, datë 18.12.2025, në kundërshtim me LZP, Rregulloren dhe cenon Nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, kërkojmë nga PZAP që të anulojë Vendimin e KQZ Nr. 01/3784-2/2025, datë 18.12.2025, si të kundërligjshëm dhe të urdherojë KQZ të

organizojë votimin fizik të votuesve të regjistruar në mënyrë të suksesshme për votim fizik në përfaqësitë diplomatike të lartcekura.

Në përgjigjen në ankesë KQZ, sqaron se më datë 9 dhjetor 2025 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar Rekomandimin lidhur me Qendrat e Votimit në Përfaqësitë Diplommatike. Ky rekomandim ka përfshirë mbylljen e qendrave të votimit me numër shumë të vogël të votuesve të regjistruar për votim fizik. Në këtë kontekst, KQZ ka vendosur që të mos hapen qendra votimi me vetëm 1 votues të regjistruar, ndërsa për misionet diplomatike me 2, 4, 6, 8, 10, 14 dhe 16 votues të regjistruar të shqyrtohet ofrimi i një modaliteti alternativ të votimit. Më datë 15 dhjetor 2025, KQZ ka pranuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes emailit, Analizën e Kapaciteteve Operacionale të Misioneve Diplommatike për Organizimin e Votimit Fizik, e cila përmban fakte për vlerësimin e realizueshmërisë së votimit fizik në misionet diplomatike përkatëse. Sipas analizës, rezulton se organizimi i votimit fizik në disa përfaqësi diplomatike dhe konsullore paraqet vështirësi serioze operative, administrative dhe financiare, për shkak të numrit tejet të ulët të votuesve të regjistruar, mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme të stafit diplomatik dhe vendor për përmbushjen e kriterit minimal të (modeli 1+4), si dhe nevojës për angazhimin e stafit shtesë përmes udhëtimeve në distanca të largëta, pajisjes me viza dhe mbulimit të kostove të konsiderueshme financiare. Për më tepër, përvoja nga zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 9 shkurt 2025, ka dëshmuar se mungesa e komisionarëve në përfaqësitë diplomatike me numër të vogël votuesve ka sjellë vështirësi serioze operative andaj këto arsye rrisin ndjeshëm barrën organizative dhe rrezikojnë respektimin e standardeve zgjedhore. rrjedhimisht organizimi i votimit fizik në këto rrethana konsiderohet jo proporcional dhe joefikas. Më tej në përgjigje theksohet se Sekretariati është bazuar gjithashtu në praktikën e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 9 shkurt 2025, ku KQZ ka vendosur mbylljen e qendrave të votimit me numër të vogël të votuesve (Podgoricë -8 votues, Tiranë - 8 votues, Kanbera - 18 votues, Ankara -25 votues dhe Lova 32 votues). Në disa raste, subjektet politike nuk kishin dërguar anëtarë të Këshillave të vendvotimeve për votimin fizik, duke e detyruar MPJD-në të angazhonte staf nga Kosova për plotësimin e numrit minimal të këshillave të vendvotimit. Sipas Ligjit-për Zgjedhjet e Përgjithshme neni 96, paragrafi 6, Komisioni i Zgjedhjeve, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet t'i përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votimi, si dhe numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë në secilën përfaqësi diplomatike. Po ashtu, në përputhje me paragrafin 7 të po këtij neni, KQZ rregullon, përmes aktit nënligjor, mënyrën e regjistrimit për votim në përfaqësi diplomatike, procedurën e votimit, mbikëqyrjes dhe-vëzhgimit, si dhe shpërndarjen, paketimin dhe dërgimin e materialit zgjedhor, përfshirë të gjitha çështjet e tjera që ndërlidhen me votimin e shtetasve jashtë Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh pamundësinë e zbatimit të Rregullores për -Votimin Jashtë Kosovës, konkretisht nenit 15, i cili përcakton se procedurat e votimit në vendvotim në përfaqësi diplomatike janë të njëjta me procedurat e votimit brenda Kosovës sipas Rregullores Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit, Sekretariati i KQZ-së ka ofruar modalitete alternative të votimit, me qëllim të garantimit të ushtrimit të së drejtës së votës dhe pa e kufizuar atë.

Opsioni 1, përkatësisht ndryshimi i Vendimit Nr. 01/3784-2025, në mënyrë që votuesit e regjistruar për votim fizik në misionet diplomatike me më pak se 16 votues të regjistruar të kalojnë në votim përmes postës. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se votuesit e regjistruar për votim fizik në përfaqësitë diplomatike të propozuara për mbyllje janë kontaktuar përmes telefonit dhe shumica dërrmuese e tyre kanë konfirmuar se nuk kanë kundërshtime në rast se KQZ vendos që votimi të realizohet përmes postës. Opsioni 2, Votimi fizik të administrohet nga një zyrtar i përfaqësisë diplomatike; kjo alternativë është vlerësuar si e pasigurt, pasi nuk garanton transparencë dhe kontroll të procesit zgjedhor sipas rregullave në fuqi. Lidhur me propozimet e Sekretariatit, KQZ në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2025 ka marrë vendim që votuesit e regjistruar për votim fizik në përfaqësitë diplomatike në Tokio, Tiranë, Podgoricë, Iowa, Abu Dhabi, Kanbera, Shkup dhe Ankara të ushtrojnë të drejtën e votës përmes postës. Si rrjedhojë, Sekretariati i KQZ ka ndërmarrë të gjitha veprimet administrative për zbatimin e vendimit, fillimisht duke njoftuar votuesit për ndryshimin e mënyrës së votimit, pastaj dërgimin e materialeve zgjedhore përmes postës së shpejtë, si dhe udhëzimet për votim me postë. Deri në këtë fazë, KQZ nuk ka pranuar asnjë ankesë/ pakënaqësi nga votuesit lidhur me ndryshimin e mënyrës së votimit.

KQZ në përgjigjen e saj thekson se në rast të ndryshimit Ose shfuqizimit të Vendimit të KQZ-së të datës 18 dhjetor 2025, realizimi i votimit fizik në përfaqësitë diplomatike bëhet objektivisht i formularëve dhe materialeve të tjera zgjedhore nuk mund të realizohet para ditës së hënë, më 22 dhjetor 2025 dhe për rrjedhojë, nuk mund të garantohet mbërritja e tyre para datës 27 dhjetor 2025, ditë në të cilën është planifikuar procesi i votimit, duke marrë parasysh edhe faktin se datat 25 dhe 26 dhjetor janë ditë festash zyrtare gjatë të cilave shërbimet postare nuk funksionojnë. Për më tepër, siguri i vizave për stafin e nevojshëm nuk është i realizueshëm brenda një afati prej tre (3) ditësh, çka e bën të pamundur angazhimin e personelit dhe garantimin e përmbushjes së kriterëve ligjore dhe operacionale për organizimin e procesit zgjedhor.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

PZAP vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se me rastin e marrjes së Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3784/2-2025, të datës 18.12.2025, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr. 01/3784-2025 për Miratimin e Rekomandimit për Qendrat e Votimit dhe Numrin e Vendvotimeve në Përfaqësi Diplomatiqe, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të jenë cenuar dispozitat e LZP-së, për përcaktim të votuesve për votim fizik në përfaqësitë diplomatike si dhe të jetë cenuar vullneti i votuesve i shprehur sipas kërkesë ligjore.

Me dispozitën e nenit Neni 96. 3 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet që *“Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së: 3.1. fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo*

hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kritereve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit. Kjo mënyrë votimi nuk aplikohet në zgjedhje lokale; 3.2. duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së, në postën e Kosovës; 3.3. duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës. Tutje me dispozitën e nenit 15 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosove, parashihet se “Që procedurat e votimit në vendvotim në përfaqësi diplomatike, janë të njëjta me procedurën e votimit në vendvotim brenda Kosovës, e përcaktuar me Rregullore 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit”.

Andaj. PZAP vlerëson se ndryshimi i vendimit për votim nga votimi në misionet diplomatike në votim me postë është bërë për shkak të rrethanave të krijuara për faktin se në rastin konkret organizimi i votimit fizik në përfaqësi diplomatike dhe konsullore në këto raste ka hasur në vështirësi operative, administrative dhe financiare, si dhe për shkak të numrit të ulët të votueseve, e po ashtu edhe për shkak të mungesë së kapaciteteve të mjaftueshme të stafit diplomatik dhe vendor për përmbushjen e kritereve ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 74 par.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ku shprehimisht është paraparë se “*Këshillat e Vendvotimeve në një qendër votimi në përfaqësi diplomatike përbëhet nga tre (3) deri në pesë (5) anëtarë*”. Po ashtu Paneli vlerëson se kjo vendosje është edhe si masë mbrojtëse për të siguruar integritetin e votës dhe kjo kurrësi nuk mund të parashihet si pengesë në ushtrimin efektiv të të drejtave të votimit të shtetasve të Republikës së Kosovës që banojnë jashtë territorit të Kosovës, përkatësisht të votuesve të regjistruar në këto qendra të votimit, pasi që sipas shkresave të lëndës është konstatuar se nga ana e KQZ janë ndërmarrë të gjitha masat për zbatimin e këtij vendimi, ku janë njoftuar të gjithë votuesit e regjistruar për ndryshimin e mënyrës së votimit, pastaj dërgimin e materialit zgjedhor si dhe udhëzimet për votim me postë. Kësaj vendosje i kontribuon edhe fakti se nga ana e këtyre votuesve nuk ka pasur asnjë ankesë lidhur me ndryshimin e mënyrës së votimit

Paneli vlerëson se Republika e Kosovës iu ka garantuar të drejtën e votës edhe shtetasve që jetojnë jashtë vendit, mirëpo e njëjta gjithashtu ka përcaktuar edhe kushte ligjore për ushtrimin e të drejtës në fjalë. Andaj edhe ndryshimi i mënyrës së votimit në rastin konkret nuk cenon të drejtën e votës së asnjë shtetasi i cili jeton jashtë vendit, andaj sipas Panelit duke qenë se caktimi i vendvotimeve jashtë Kosovës është i përcaktuar me ligj, qëllimi i ligjvënësit është që të përcaktohen saktë vendvotimet jashtë Kosovës, pra duke i caktuar qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, e që sipas Panelit është një qëllim legjitim që është synuar të arrihet me këtë ndryshim të votimit, krejt kjo për të garantuar integritetin e procesit të votimit jashtë Kosovës, e i cili kufizim nuk do të ndikon në shprehjen e lirë të vullnetit të popullit përkitazi me përfaqësuesit e tyre në Kuvend, duke qenë se me këtë ndryshim të votimit, shtetasve konkret nuk u është pamundësuar votimi, pasi që votuesit jashtë Kosovës kanë të drejtë dhe mund të votojnë fizikisht, në Përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së në postën e Kosovës dhe duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Me rastin e vendosjes paneli ka vlerësuar edhe pretendimin ankimor i palës ankuese se ligjvënësi, duke i patur parasysh të gjitha rrethanat, ka përcaktuar vetëm normën numri maksimal të votuesve, por jo edhe numrin minimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike, që sipas vlerësimit të panelit edhe pse ligji ka paraparë vetëm kriterin maksimal, nuk e mohon të drejtën e KQZ që për shkak të arsyeve të ndryshme si në rastin konkret të ndryshojë mënyrën e votimit për shkak të numrit të vogël të votuesve dhe mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme të stafit, andaj nga kjo rezulton se ndryshimi i mënyrës së votimit për shtetasit që jetojnë jashtë vendit, nuk mund të konsiderohen si cenim i të drejtës së votimit, krejt kjo me qëllim të garantimit të integritetit zgjedhor, pasi që lejimi i votimit në përfaqësi diplomatike në mungesë të kapaciteteve të stafit (e cila edhe ka qenë si opsion i dytë), mirëpo një vendosje e tillë sipas vlerësimit edhe të panelit do të mund të cenojë integritetin zgjedhor.

Nga të lartpërmendurat si dhe bazuar në shkresat e lëndës Paneli vlerëson se KQZ me Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3784/2-2025, të datës 18.12.2025, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit Nr. 01/3784-2025 për Miratimin e Rekomandimit për Qendrat e Votimit dhe Numrin e Vendvotimeve në Përfaqësi Diplomatieke, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, ka respektuar dispozitat e lartcekura lidhur me të drejtën e votimit jashtë Kosovës, sepse shprehimisht KQZ ka për obligim që shtetasve të saj t'ia mundësojë të drejtën për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare. Mënyrën e votimit për shtetasit jashtë vendit KQZ duhet të bëjë sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore, e që e ka bërë në rastin konkret, andaj sipas vlerësimit të panelit me këtë vendosje nuk iu është mohuar apo cenuar e drejta e votimit për shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 par.2 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2025), për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 118 par.1 dhe 119 par.3 dhe 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të bazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.27/2025, datë: 22.12.2025

Kryesuesi i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.